



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1529/2 prot.,

Datë 04.07.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR DHE ZHVILLIMIN E
PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ufo Cengu” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-70621-05-25-2023, me objekt: “*Blerje karburanti*” me fond limit 21.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Ankimues: “Ufo Cengu” SHPK.
Lagjja Ramhas, Rruga Deshmoreve, Zona Kadastrale Nr.2315, Nr.Pasurie 8/8, Kukës

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kukës
Sheshi “Skenderbej,, Lagjia Nr.5, Kukes

Në datën 03.07.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1529/2023 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3227 e e operatorit ekonomik “Ufo Cengu” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-70621-05-25-2023, me objekt: “*Blerje karburanti*” me fond limit 21.000.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 19.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Ufo Cengu” SHPK si dhe ngrihen pretendime për zhvillimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Ufo Cengu” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr 1529 prot.

Arsyet e skualifikimit:

a.OE nuk disponon autorizimin për tregtim të lendeve djegese(gazoil) me pakice, pasi ky dokument ka kaluar afatin e skadences dhe nuk është i rinovuar afati.

b.OE nuk ben sqarimet e nevojshme sa i perket shtojces Nr.8 B.Deklarata per dorezimin e ofertave te pavarura pika 6

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.07.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri